



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 13/15

Prishtinë, më 01.04.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjona, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Bojan Mitić.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Agim Krasniqi - Zv. Ministër i Financave, Hilmi Jashari, Agon Gashi dhe Kushtrim Kaloshi nga Kampanja Drejtësia dhe Qytetarët, Safet Hoxha - Kryetar i KRPP-së, Hysni Hoxha - Kryetar i OSHP-së.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Islami nga GIZ, Lumnije Murati-Udhëheqëse e Divizionit-ZPRK, Sylejman Blakau nga Kosova Sot, Berat Thaqi nga GAP Institut, Alketa Bala nga ATRC, Melita Bytyqi-Kelmendi nga PILPG

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashuriye Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 12.3.2015, 17.3.2015 dhe 24.3.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FACTA;**
- 4. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2015;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me Vendim të Gjykatës ose të panelit për lirim me kusht, dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**
- 6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare;**
- 7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014;**

8. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2014;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatohet se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 12.3.2015, 17.3.2015 dhe 24.3.2015

Kryetari - konstatohet se komisioni miratoi procesverbalet, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA

Kryetari – njoftoj se Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA. Kjo marrëveshje ka të bie më shumë për detajet e këmbimit të informatave se që ka ndonjë ndërhyrje të drejtpërdrejt në çështje të interesit ekonomik.

Avdullah Hoti - sqarohet se marrëveshja ka për qëllim të luftojë evazionin fiskal të shtetasve amerikan. Në bazë të marrëveshjes, Institucionet Financiare në Kosovë kanë për obligim të raportojnë për shtetasit amerikan që kanë llogari të ndryshme në Kosovë. Ministria e Financave i ka ndjekur të gjitha hapat ligjor sa i përket mbrojtjes e të dhënave personale, të drejtave të njeriut edhe konfidentalitetin e të dhënave financiare të shtetasve amerikan në Kosovë. Në përputhje me ligjet e Kosovës është marr miratimi dhe aprovimi nga presidentja për të negociuar këtë marrëveshje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatohet se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA.

4. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2015

Kryetari – njoftoj se gjatë hartimit të buxhetit të Kosovës kemi premtuar që ashtu siç e parasheh ligji do shqyrtohet draft propozimi i buxhetit të Komunës së Prishtinës. Mirëpo, pasi që të kaloj procedurat e rregullta të aprovimit në Asamblenë komunale. Çështja e granteve nuk është çështje e dëshirës së Komunës sepse, është një Komision që e përcakton grantin duke e përdorur formulën që zbatohet ndarja e granteve.

Agim Krasniqi – informon se për shkak të mosrespektimit të qarkores buxhetore, Kuvendi i Kosovës me datën 29 Dhjetor 2014, ka miratuar buxhetin e komunës prej 55,872,234 euro. Pjesë e tabelave të buxhetit 2015, ka qenë një tabelë që ka paraqit ndryshimet mes buxhetit që është dashur të aprovohet nga Kuvendi Komunal. Komuna e Prishtinës ka dorëzuar në Ministrinë e Financave buxhetin e ri-aprovuar me datë 24.02.2015, i cili është i harmonizuar me qarkoren buxhetore. Komuna e Prishtinës ka respektuar plotësisht buxhetin ashtu siç ka qenë e paraparë në ligjin për buxhet, në tabelat 01 dhe 02 dhe tani është në shumën 62,114,156 euro dhe është respektuar pjesa që ka të bëjë me grantet. Grantet qeveritare janë në shumën prej 34,951,547 euro dhe të hyrat vetanake janë 27,162,609 euro, po ashtu, edhe pjesa që ka të bëjë me strukturë dhe shpenzime është aprovuar. Më pas iu referue nenit 62.4 të LMFP, rreth procedurës së miratimit të buxhetit të komunës, pas miratimit të Ligjit të buxhetit nga Kuvendi. Ne e rekomandojmë KBF me miratue buxhetin e Komunës së Prishtinës, pasi që Kuvendi Komunal ka aprovuar buxhetin për vitin 2015 duke u mbështet në tabelat që janë të lartë përmendur dhe ka respektuar qarkoren buxhetore nga Ministria e Financave. Sipas asaj që ne po e interpretojmë, nuk ka nevojë edhe njëherë të riaprovohet nga ana e Kuvendit buxheti për Komunën e Prishtinës.

Kryetari – njofton se i kemi dy buxhete të aprovuara nga Asambleja Komunale një buxhet i cili është në shumë 55,872,234 euro të aprovuar me 22.12.2014, që nuk paraqet fare problem për me integru në buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe një tjetër buxhet të riaprovuar me shumën 62,114,156 euro. Nëse kjo shumë aprovohet atëherë paraqitet një rritje prej 6,241,922 euro dhe si rezultat duhet ndërhyrë në tabelat që kanë të bëjnë me të hyrat e përgjithshme të komunave.

Safete Hadergjonaj – theksoi se Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës është një ligj sikurse ligjet tjera, dhe ne nuk mundemi të shkojmë me një ndryshim të tillë, pa bërë amendamente. Mandej, po më duket që jemi dalë jashtë sistemit me një formë të tillë të miratimit.

Kryetari – njoftojë se katër komunat e pjesës veriore të Kosovës që nuk kanë kaluar procedurën e rregullt të buxhetit mund të kenë buxhet vetëm sipas vitit të kaluar, ashtu siç e parasheh ligji.

Avdullah Hoti – sqaroj se qarkorja buxhetore e komunave e ka paraparë që Komuna e Prishtinës të miratoj një buxhet prej 62 milion euro. Ndërsa Komuna e Prishtinës e ka tejkaluar atë që është paraparë dhe ka miratu një buxhet penj 67 milion euro. Si rezultat i këtij tejkasimi Ministria e ka dërguar buxhetin e Komunës së Prishtinës në Kuvend, për të aprovuar një buxhet të vitit paraprak. Kuvendi i Kosovës kur ka aprovuar buxhetin për komunën e Prishtinës në shumë prej 55,872,234 milion euro dhe po ashtu ka lënë rezervën prej 6.2 milion euro në mënyrë që kur Komuna e Prishtinës, ta miraton buxhetin në përputhje me qarkoren buxhetore, këto mjete vetëm të alokohen nëpër programe përkatëse. Komuna tani ka aprovuar buxhetin plotësisht sipas qarkores.

Kryetari – buxheti i riprovuar duhet të shpërndahe nëpër pozicione në tabelat buxhetore.

Avdullah Hoti – ashtu siç e ka miratuar Komuna e Prishtinës. Po ashtu duhet të jetë në procesverbal që Kuvendi është pajtuar që kurdo që Komuna e Prishtinës e miraton buxhetin në përputhje me qarkoren buxhetore, atëherë Qeveria sjell në komision njoftimin që është aprovuar buxheti në përputhje me qarkoren dhe bëhet përshtatja në tabelat buxhetore.

Ilir Deda – e përkrah mendimin e ministrit dhe të zv. ministrit, sepse buxheti prej 62 milion është i aprovuar me 29.12.2014, kur është votuar buxheti i Republikës së Kosovës. Nga procesverbali i asaj date, Qeveria ka propozuar, që pasi që Kuvendi komunal të aprovon buxhetin në përputhje me qarkoren buxhetore, Kuvendi i Kosovës, e autorizon Ministrinë e financave të bëjë përmirësimin e tabelave buxhetore, me shtesën prej 6.2 milion euro.

Avdullah Hoti – theksoi se është e autorizuar ministria kur është votuar buxheti.

Kryetari – ne e përcjellim rekomandimin në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe neni 62.4 dhe rekomandojmë për aprovim dhe le të përshtatet në bazë të rregullave dhe ligjeve në fuqi. Pra ne rekomandojmë që Kuvendi të aprovoj buxhetin e Komunës së Prishtinës dhe të bëhet pjesë e buxhetit të Kosovës, sipas ndarjeve që janë bërë vetëm për Komunën e Prishtinës, por që nuk ndikon në tabelat e buxhetit të përgjithshëm.

Besa Gaxherri - a ka mundësi mos me u dërgue fare në Kuvend?

Kryetari – sqaroi se Komisioni, siç është paparë specifikisht me ligj, vetëm për çështjen e ndryshimit të akcizave në konsultim me Ministrin e Financave merr vendim dhe nuk e dërgon në seancë. Përndryshe të gjitha rekomandimet tjera shkojnë në seancë për votim.

Latif Gashi - ne e kemi një dilemë se a është njoftim për kryesinë apo rekomandim për seancë, për shkak se e kemi marrë një vendim më herët për këtë çështje?

Safete Hadergjona – nëse është për njoftim atëherë, kjo nuk është dashtë me shkue në Kryesi por vetëm ishim njoftue si deputet dhe nuk kishte pas diskutime të mëtutjeshëm. Mirëpo, nga materiali shohim se nga Kryesia, jemi ngarkuar si komision funksional, që të shqyrtojmë buxhetin e Komunës dhe ta paraqesim raportin me rekomandime.

Kryetari – me lejoni si kryetar i komisionit të konsultohem për procedurat. Nëse është për rekomandim e përcjellim si rekomandim dhe nëse është për informim, ekziston mundësia ta përcjellim për informim.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Kryetari i Komisionit autorizohet të konsultojë procedurat dhe bazën ligjore, për të parë nevojën e hartimit të rekomandimit të Komisionit për seancë plenare apo që çështja të dërgohet për informim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me Vendim të Gjykatës ose të panelit për lirim me kusht, dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Kryetari – sqaroi se qëllimi i projektligjit mbikëqyrja elektronike e personave të cilëve iu ipet e drejta e mbajtjes së dënimit me arrest shtëpiak apo me liri të kufizuar. Ky projektligj vë në rend një sistem që vjen me pajisje trupore dhe në mënyrë automatike e signalizon pozicionin se ku gjindet personi. Ligji është paraparë të hyn në fuqi në Korrik dhe kostoja buxhetore që është paraparë, mund të trajtohet me rishikim të buxhetit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me Vendim të Gjykatës ose të panelit për lirim me kusht, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare

Kryetari – njofton se ky projektligj ka të bëjë me ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, respektivisht nenit 69, dhe Propozuesi që është një nismë qytetare, e përfaqësuar nga Kompania Dritësia dhe Qytetaret, kërkojnë kompensim jo vetëm ekonomik por edhe kompensim të dëmeve jo-ekonomike. Ky ndryshim mund të ketë kosto shumë të mëdha.

Avdullah Hoti – njofton se Qeveria ka planifikuar ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike. Një nga këto ka të bëjë edhe me pikën e diskutimit për buxhetin e Komunës së Prishtinës. Sugjerojmë që këtë propozim që e ka nisma qytetare, ta shqyrtojmë bashkërisht me rastin e propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në qeveri, që do të bëhen gjatë këtij viti.

Hilmi Jashari – njofton se çështja kyçe e projektligjit, ka të bëjë me kompensimin e viktimave në shkeljet e Drejtave të Njeriut. Neni 69 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e eviton mundësinë e kompensimit të viktimave në shkeljen e të drejtave të njeriut sa i përket dëmeve jo-ekonomike dhe parasheh vetëm kompensimin e dëmeve ekonomike që shkaktohen si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të Organeve Publike të Kosovës. Kjo është në kundërshtim edhe me Kushtetutën edhe me ligjin bazë dhe është konflikt i drejtpërdrejtë dhe e cenon shumë rënd drejtat dhe lirit e gjyqarëve.

Kryetari – do të thotë të gjithë ata që fitojnë lenden në proces gjyqësor, kanë të drejtë të kërkesës së kompensimit jo ekonomik. Kjo do të ketë kosto të lartë të buxhetit.

Hilmi Jashari – kostoja buxhetore në çdo shtet për shkeljen e të drejtave të njeriut është shumë e thjeshtë, nëse nuk doni me pas kosto buxhetore atëherë mos të shkelen drejtat e njeriut. Në çdo shtet pavarësisht shpenzimeve buxhetore duhet të ketë detyrim primar, që në moment kur shkelen të drejtat e njeriut, të parashihet edhe pjesa e kompensimit për dëmet.

Kryetari – kjo i paraprinë kompensimit që pritet ti bëhet grave të dhunuara?

Hilmi Jashari – po defenitivisht.

Avdullah Hoti – theksoi se si ministër i financave nuk mundem me u pajtu me nënshkrue një faturë dhe vlerën me vendos më vonë. Ne gjithmonë duhet të vendosim disa terme edhe nene me të cilat ne paraprakisht jemi në dijeni për koston financiare. Prandaj rekomandimi i im është që këtë propozim ta shqyrtojmë bashkërisht kur të fillojmë me amendamentim e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.

Ilir Deda - standardet e drejtave të njeriut janë të obliguara edhe në Kosovë dhe ne duhet ti respektojmë. Pyetja ime është sa e llogaritet kompensimi vetëm ndaj institucioneve të Kosovës prej vitit 2000 e deri me sot, apo po kthehemi edhe para vitit 2000, dhe po e marrim përgjegjësitë e shkeljeve që janë bërë nga një shtet tjetër? Pra, duhet të sqarohet se në cilën periudhë po iu referohet kompensimi? Në qoftë se është nga momenti që janë themeluar institucionet e Kosovës, atëherë nga ana ime, e keni përkrahjen e plotë në procedimin e këtij projektligji.

Hilmi Jashari – sqaron se fjala është për të gjitha ato raste të cilat mund të paraqiten në gjykata për periudhën aktuale jo për periudhat paraprake dhe jo për situatat për të cilat dikush tjetër mund të kishte qenë kryes i veprave penale. Mirëpo po flasim për dëmet që i shkaktajnë Institucionet e Republikës së Kosovës ndaj qytetarëve të vetë, qoftë me veprim apo mosveprim, me dashje apo pa dashje. Në bazë të ligjit në fuqi, gjykata është e parandaluar me vendos për kompensimin e të dëmëve jo-ekonomike. Krijohet një situatë që shkaktohet një konfuzion të madhe te gjyqtarët, sepse ligji tjetër bazë që ka të bëjë me procedurën kontestimore dhe ai procedurës penale, e lejon kompensimin e dëmeve jo ekonomike. Rreziku është më i madh që në të ardhmen në praktika gjyqësore të kemi qasje selektive të gjyqtarëve që ka me ndiku defenetivisht paanshmërinë e tyre. Kjo është në shpërputhje me frymën kushtetuese me Konventën për të drejtat e njeriut dhe me dy ligjet bazë që aplikohen, që përmenda më lartë, nga gjykatat.

Ilir Deda - pyeti se ligji a do të vlente nga 18 shkurti 2008?

Hilmi Jashari – në pyetjen e parafolësit sqaroi se, po vetëm nga ajo datë.

Agim Krasniqi –nga aspekti i drejtave të njeriut është në rregull dhe jemi në dijeni se çka thotë legjislati, mirëpo nga aspekti procedural kjo iniciativë nuk i plotëson kriteret të vazhdoj tutje, për arsye se nuk e ka vlerësim financiar. Ministria është duke përgadit plotësim-ndryshimet për ligjin e menaxhimit të financave publike. Bashkërisht në procedurë thirrje edhe në pjesën që ka të bëjë me shoqërinë civile dhe diskutohen iniciativat, dhe në fund e konstitujmë dhe japim vlerësimin financiar dhe buxhetor.

Bardhyl Meta – theksoi se ligji ka për detyrë edhe të disiplinojë në mënyrë që të ndalohen shkeljet për shkak kostos dhe si rezultat kjo krijon kulturë të sjelljes institucionale. Të thuhet se nuk ka buxhet për këtë çështje dhe le të ndodhë çfarëdo situatë është absurd. Do të ishte mirë që nga ana e ministrisë të caktohet një kohe deri në shtator, në mënyrë që të shqyrtohet kjo çështje, bashkarisht me ndryshimet tjera.

Safete Hadergjonaj – nëse projektligji nuk e ka koston buxhetore të kalkuluar atëherë rekomandimi i komisionit nuk mund të jetë pozitiv. Edhe nëse kalon në Kuvend ne duhet të rikthehemi tek Qeveria dhe të kërkojmë një kalkulim të koston financiare. E kuptoj se çështja ka të bëjë me drejtat e njeriut dhe vendimet gjyqësore, mirëpo, nuk mund të bëhen ndryshimet në një ligj, pa pas koston buxhetore të kalkuluar.

Kryetari – jemi në dijeni për të drejtat e njeriut sepse këto na konvenojnë të gjithëve, por kjo ka të bëjë më shumë me mundësitë. Rregulli është që çdo projektligj duhet ketë koston buxhetore dhe qeveria nuk ka dhënë mendimin lidhur me këtë projektligj, siç parashihet me Rregulloren e Kuvendit. Tash ekzistojnë dy mundësi, ose edhe njëherë të kërkojmë nga ministria e financave të bëjnë një vlerësim buxhetor dhe të kërkojmë një shtyrje të afatit nga Kryesia e Kuvendit, ose mund të kërkojmë nga Kampanja që të tërheqin me shkrim propozimin dhe të bashkëpunojnë me ministrin e financave për shkak se është në proces ndryshimi i ligjit në fjalë.

Agim Krasniqi – informon se çdo iniciativë për të plotësuar dhe ndryshue ligjin duhet të përcillet me një vlerësim fillestar prej sponzoruesit. Nuk mundet qeveria me dhënë një vlerësim, pa pas një vlerësim së pari nga sponzoruesi.

Besa Gaxherri - si mundet me u bo kostoja buxhetore për kompensim emocional? Ne nuk mundemi me parashiku se kush ose kujt, ka me iu shkaktuar dëmi emocional.

Avdullah Hoti – theksoi se ne nuk mundemi me nënshkrue fakturë të hapur pa vlerësim. Nëse pajtohet Kampanja me punu bashkarisht dhe ne të bëhemi sponzorues i këtij ligji dhe e bëjmë vlerësimin e kostos financiare.

Ilir Deda - nuk mundet kostoja buxhetore të parashihet në bazë të vendimeve të cilat nuk janë marr dhe vendimeve të cilat i merr gjykata në të ardhmen. Ligji nuk mund të ketë vlerësim buxhetor sepse po paragjykohet: nën një, shkelësi, nën dy, dëmi dhe nën tre, vendimi i gjykatës. Ky ligj mund të ketë më shumë efekt parandalues mos me ardhur deri tek shkeljet e kësaj natyre.

Enver Hoti – theksoi se Kompania “Drejtësia dhe Qytetaret”, plotësisht e kanë argumentuar iniciativën. Vërehet se ligji aktual për menaxhimin e financave publike, e kufizon dëmin vetëm për kompensimet e natyrës ekonomike. Propozimi është që nenit 69 të këtij projektligji, ti shtohet edhe kompensimi i natyrës jo-ekonomike dhe shpërblimi të njihet në mënyrë të barabartë si për dëmin ekonomik po ashtu edhe atë të natyrës jo-ekonomike, dhe unë e mbështes këtë propozim dhe procedimin e mëtutjeshëm të projektligjit.

Latif Gashi - theksoi se edhe përfaqësuesit e kësaj iniciative janë dakord që ky ligj paraprakisht duhet të ketë një llogaritje të kostos buxhetore. Jam dakord me atë që e thanë parafolësit se është një preventivë shumë e mirë për Institucionet e Kosovës. Propozimi im është të formohet një grup pune në lidhje me këtë çështje dhe së bashku me Qeverinë të punohet, ose të autorizojmë Qeverinë dhe t’ia përcaktojmë një afat për të bërë vlerësimin e kostos buxhetore që mund të jetë e përafërm, e jo definitive.

Safete Hadergjonaj – theksoi se ligji hynë në fuqi pas miratimit në Kuvend dhe vlen për periudhën në vazhdim, dhe kjo do të thotë se nuk barten obligimet e mëparshme, dhe në rastin konkret, ligji nuk i përfshin veprimet nga 2008, sepse ligji zbatohet vetëm nga dita kur miratohet në Kuvend. Pra dëmet llogariten vetëm nga data e hyrjes në fuqi të ligjit dhe jo në mënyrë retroaktive. Mendoj se mundet me u bë një kalkulim buxhetor, duke edhe nga përvoja e gjykatave gjatë vitit 2014, sepse i tërë buxheti është me planifikime. Prandaj rekomandimi është që të plotësohet projektligji me deklaratat siç e parashohin ligjet dhe rregulloret, në mënyrë që ti ketë të gjitha dokumentacionet e përfshira për miratim në Kuvend.

Kryetari - nëse nuk ka një kriter të kompensimit të kësaj natyre, atëherë është mundësia e hapur dhe jemi në dorën e gjygtarve dhe vlerësimit tyre. Duhet të detalizohen gjërat në mënyrë që kur të bëhet ndarja e drejtësisë të jetë një kriter i kompensimit për të dëmtuarit.

Safete Hadergjonaj – pyeti propozuesit a ka ndonjë vlerësim për dëmet jo-ekonomike, me shifra, në vendimet të cilat i merr gjykata?

Hilmi Jashari – njofton se Kushtetua e Kosovës ka miratu mbi tetë Konventa ndërkombëtare që janë të zbatueshme drejtpërdrejtë në sistemin tonë juridik dhe gjithashtu përmban më tepër se 25 drejta të numëruara në mënyrë individuale, dhe nuk besoj që kanë pasë një kalkulim të kostos financiare për respektimin e Konventave, por janë miratuar në parim në organin më të lart të vendit. Nëse e nxjerrim një kosto financiare kjo nënkuptohet që jemi darkodu se gjatë këtij viti kemi për ti dënuar penalisht një numër të caktuar dhe nëse del jashtë këtij numri për shkak kostos financiare, nuk kemi me mujt me veprue.

Besa Gaxheri – njoftoi se duke u bazuar në ligjin për nismën legjislative, neni 20 pika 2 thotë: në rastin kur nisma legjislative e qytetarëve është në form të projektligjit, Kuvendi është përgjegjës për shqyrtimin e tij konform rregullores së punës së Kuvendit. Kuvendi projektligjin ja dërgon Qeverisë për marrjen e opinioneve dhe deklaratave përkatëse. Pas marrjes së opinioneve dhe deklaratave përkatëse

nga Qeveria, fillon shqyrtimin e projektligjit sipas procedurës të caktuar në Rregulloren e Kuvendit. Procedurat e lartpërmendur duhet të zbatohen nga deputetët.

Latif Gashi – kostoja buxhetore nxirret shumë lehtë duke u bazuar në praktikat gjygjësore. Ligji kur të aprovohet ka me pas efekt preventiv dhe jemi dakord se nuk ka me u shpenzu ai buxhet. Jam pro kësaj iniciative mirëpo, duhet me gjet rrugën me bashkpunue me Qeverinë.

Kryetari – pyeti përfaqësuesit e nismës legislative, nëse tërheqin vullnetarisht projektligjin, dhe çështje të kalojë në qeveri, kur do të diskutohen propozimet e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike, dhe ku nisma të përfshihet në grupet punuese.

Hilmi Jashari – e kam shumë problem me tërheq nismën nga se janë 13,000 nënshkrime të qytetarëve. Qëndrimi i tre koordinatorëve të kësaj nisme është që të mbetet propozimi fillestar.

Safete Hadergjona – në bazë të propozimit për ndryshimin e nenit 69 thuhet se dëmet e drejtpërdrejta ekonomike dhe dëmet e natyrës jo-ekonomike, të cilat janë të vërtetuara nga gjykata në bazë të provave të shpërblehen në mënyrë të barabartë. Kush i vlerëson këto dëmet jo-ekonomike dhe si mund të shpërblehen në mënyrë të barabartë? A janë të vërtetuara këto dëmet jo-ekonomike deri tani?

Hilmi Jashari – sqaroi se ligji për procedurën disiplinore dhe ligji për procedurën penale është ligj bazë për punën e gjykatësit. Të dy ligjet përfshijn dëmet jo-ekonomike, por i vetmi përjashtim që i bëhet këtij parimi themelor të funksionimit të drejtësisë është ligji për menaxhimin e financave publike.

Kryetari - theksoi ligji i menaxhimit të financave publike është kushtetutë për qështjet financiare dhe të gjitha ligjet bazike dhe ligjet tjera duhet ti referohen këtij ligji në këtë aspekt.

Latif Gashi – plotësisht do të isha dakord edhe pa kosto buxhetore me u aprovu nisma juaj, në qoftë se do të kishit propozuar në projektligj edhe një ndryshim tjetër, që institucioni korrektues të kërkojë nga dorasi apo faktori të punojë dhe nga puna e tij me u kompensue familja e tij. Pra, i burgosuri duhet të punojë për shtetin dhe përmes punës së tij shteti të kujdeset për kompensimin e familjes apo fëmijëve të tij. Në Kosovë, shërbimet tona korrektuese nuk e kryejnë si duhet punën tyre për risocializimin e të dënuarve në shoqëri.

Hilmi Jashari – njofton se ligji për menaxhimin e financave publik po flet për përgjegjësit që ka institucioni publik dhe kompensimin që duhet me bo shteti, dhe ky është dallimi nga sektori privat.

Latif Gashi - duhet të ekziston një fond i caktuar dhe nga ai të bëhet kompensimi.

Pas diskutimeve, sqarimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoj se komisioni unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
2. Qeveria të përgatitë dhe dërgojë në Kuvend, Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së së këtij Projektligji, në afatin prej një muaji nga dita e miratimit në parim të Projektligjit.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës dt. 01.04.2015, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit nr. 16/20, dt. 24.3.2015 për ndryshimin e normave të akcizës

Kryetari – njoftoi se Qeveria e ka një propozim-vendim për ndryshimin e vendimit të datës 24.3.2015, që ka të bëjë me ndryshimin e normave të akcizës, për të si komision jemi konsultuar dhe jemi pajtuar. Tani me propozimin-vendimin e ri është kërkuar të bëhet një përmirësim, për një lëshim teknik që është bërë me vendimin e mëparshëm. Kërkuar që në paragrafin 2.1, para pikës së parë shtohet pika si vijon: Veturat e reja të përgjithshme do të jenë të lira nga tatimi i akcizës. Si dhe në paragrafin 4, pika e parë ndryshohet si vijon: 24021000 Cigaret, cigaret e prera dhe cigarelloset të cilët përmbajnë duhan në shumë prej 1.10 € për njësi konvencionale.

Latif Gashi – ju kisha lutur si ministri në të ardhmen mos me na sjellë këso vendime të shpejta dhe urgjente dhe realisht është dashur të përfillen procedurat që mos të ndodhin edhe këto gabime teknike. Në media ka dal se është bërë edhe rritja e akcizës për cigare dhe ne si komision e kemi aprovu kërkesën e qeverisë. Të gjitha kontaktet që unë i kam pas me qytetarët dhe me njerëz njohës shumë të mirë të kësaj fushe dhe me njerëz në PDK, opinioni i tyre është se kemi me e rrit informalitetin, kontrabandën edhe ka me ndikue shumë negativisht, sepse ne rajon është më lirë se këtu.

Bardhyl Meta – theksojë se në vitet e 60-ta në Ish Jugosllavi, ka qenë e rregulluar që nëse dikush prej diasporës është kthyer, ka pas mundësi me i sjellë mjetet e caktuara prodhuese, si kombaj, maquina apo vetura, pa doganë dhe pa TVSH. Mos të kemi sot këtë lehtësi, që kemi diasporën më të madhe dhe në ndërkohë nuk jemi prodhues të automjeteve, po më duket absurde. Automjeti është i domosdoshëm në ditët e sotme dhe ka shumë që duan prej diasporës me iu dërgue automjetin prindërve të vetë dhe aplikohen ngarkesa të caktuara. Kjo formë duhet të dallohet nga forma kur automjeti përdoret për tregti. Unë mendojë që nuk është as trajtim njerëzorë ndaj asaj diasporë që ka dhënë shumë për këtë vend.

Kryetari - sqaroi se kategoritë e caktuara e kanë të lejuar me ligj, lirin nga akciza e veturave.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoj se komisioni unanimisht nxori këtë

P e r f u n d i m

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dt. 01.04.2015, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë nr. 16/20, dt. 24.3.2015 për ndryshimin e normave të akcizës dhe shtimin e listës së mallrave që do të nënshtrohen normës së tatimit të akcizës, si vijon:
 - a. Në paragrafin 2.1, para pikës së parë shtohet pika si vijon:
 - Veturat e reja të përgjithshme do të jenë të lira nga tatimi i akcizës.
 - b. Në paragrafin 4, pika e parë ndryshohet si vijon:
 - 24021000 Cigaret, cigaret e prera dhe cigarelloset të cilët përmbajnë duhan në shumë prej 1.10 € për njësi konvencionale.

8. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014

Safet Hoxha – sqaroi se raportimi i KRPP-së bëhet në aspekte. Në njërin ne raportojmë për të arriturat edhe zhvillimin në fushën e prokurimit publik në nivel të Kosovës dhe pjesa e dytë ka të bëjë me raportimin e punës së KRPP-së. Vitin e kaluar, numri i kontratave të nënshkruara ka qenë 11.362, vlera e kontratave të nënshkruara është 389,732,957 euro, pa vlerën e pagesës së autostradës Prishtinë – Hani i Elezit, që kemi një pagesë prej 55,468,528 euro. Në raport nuk është hyrë vlera e analizës së kontratës

prej 600 milion euro. Në total vlera e kontratave të nënshkruara ka qenë 66.42 e kontratave qeveritare që janë paguar nga buxheti i Kosovës janë 238,872,264.05 euro, 33.32% nga të hyrat vetanake apo 129,808,495.46 euro, nga donacionet 1,057,198.09 euro. Ndërkaq vlera e kontratave për ndërmarrjet publike ka arritur shumën prej 129,579,279.93 euro. Sipas llojit të prokurimit publik ne kemi një strukturë prej 159 milion që janë kontrata në punë, mallrat 40%, shërbimet janë 11%. Rritjen e kontratave për mallra e kanë rritur kontratat kornizë apo afatgjate. Siç është rasis që AQF vitin që e lamë pas, ka nënshkruar një kontratë prej 14 milion euro, ndërsa furnizimet nuk janë bërë në atë vlerë, ato do të interferojnë edhe në raportet e viteve vijuese. Sipas vlerës del se 63% ka qenë vlera të mëdha, 30.57% kanë qenë vlera të mesme, 5.69% vlerat e vogla, ndërsa vlerat minimale janë 0.59%. Procedura e hapur ne total ka qenë e përdorur 72%, në nivel qeveritar është 83.38%, të ndërmarrjet publike është 50.75%, procedura e negociuar pa publikim është 12.98%, në nivel qeverisë është 8.7% , ndërsa te ndërmarrjet publike e kemi 24%. Proceduar e negociuar pas publikimit në nivel qeveritar nuk kemi, ndërsa të ndërmarrjet publike e kemi 24.64%. Ndërsa koutimi i çmimeve është 7.16%, aneks kontratat janë 1.43% e totalit të kontratave. Sa i përket operatorëve ekonomik, del që 73% janë operatorët vendor dhe 26.13 janë operatorët ekonomik të huaj.

Sa i përket pjesës së punës që lidhet direkt me KRPP-në, kemi dhënë 2966 interpretime dhe kemi nxjerr tri udhëzime. Po ashtu nga 42 autoritete kontraktuese të planifikuara, janë monitoruar 38 autoritete, dhe gjithsej i kemi monitoruar 283 aktivitete të prokurimit publik, ku i kemi monitoruar edhe implementimin të kontratës. Ndërsa 7 aktivitete të prokurimit i kemi bërë sipas rastit, respektivisht sipas kërkesës së autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik apo palëve të interesuara. Monitorime paraprake janë 260. Vitin e kaluar kemi monitoruar kontratat e vlerave të mëdha dhe këtë viti kemi filluar edhe me kontratat e mesme. Sa i përket trajnimeve, kemi trajnuar në nivel bazik 15 module dhe 118 zyrtar, janë certifikuar 109 zyrtar, në nivelin e avancuar ka ndjekur trajnimet 95 dhe provimin e ka dhënë 44. Kështu që, Kosova i ka momentalisht 736 zyrtar të certifikuar për prokurim, prej tyre 513 e mbajnë certifikatën e avansuar në këtë fushë. Vitin e kaluar i kemi hartuar edhe disa lista referente për disa produkte. Kemi filluar edhe me 4 aktivitete tjera me monitorim të performancës në prokurim publik dhe në hartimin e strategjisë për trajnime fushën e prokurimit publik, hartimin e strategjisë në prokurim publik dhe hartimin e strategjisë për koncept dokumentin për ndryshimin në fushën e prokurimit publik.

Kryetari – kërkoi sqarim për mosshpezimin e buxhetit për E-prokurimin?

Safet Hoxha – sqaroi se realizimi i projektit të E-prokurimi ka pasur vonesa për dy arsye, e para ka qenë një insistimi Bankës Botërore që E-prokurimi të zhvillohet një modifikim dhe të ruhen kodet burimore, e ne kemi insistue që mos ti mbajmë kodet sepse na kushton shumë mirëmbajtja e tyre dhe e dyta arsyeje ka ndikuar situata e ngërçit institucional dhe si rezultat kontrata është nënshkruar më 8 dhjetor 2014, ku është shpallur kompania fituese e tenderit. Implementimi i këtij projekti ka me qenë me faza provuese në tri aktivitete. Aktiviteti i parë ka me qenë furnizim me bileta për qeverinë, ku vlerësojmë se Avio kompanitë janë më të përgatitur për të filluar këtë proces, e dyta për posten sepse ka teknologji të mirë dhe e treta është një institucion publik që besojmë që është ministria e kulturës.

Kryetari - pyetje ju i keni dhënë shumë rëndësi monitorimit e trajnimeve të zyrtarëve të prokurimit ku janë mbi 700 të licencuar. Te rasti i prokurimit ka dikun 537 ankesa, në rivlerësim janë 161, ritenderim 104, do me thënë se është një numër i madh i atyre që kanë bërë ankesa. Në bazë të kësaj del që zyrtarët e prokurimit nuk janë në nivelin profesional, ose ka shkelje të qëllimta ose ka shkelje për shkak të mangësisë së përvojës së tyre ose kanë bërë përzgjedhje të gabuar.

Safet Hoxha - certifikimi e vlerësimit të kandidatëve është çështje e IKAP-it, ndërsa në e kemi çështjen e kutikulave, programit e trajnimeve. Tek ne prokurimi është mjaftë i ngurtë në punën e procedurave dhe rregullave. Në vendet e BE-së mbështetet në parime, a është respektuar konkurrenca, parimi i vlerës së parasë, ndërsa tek ne është krejt në aspektin formal.

Bali Muharremaj – si ka mundësi dhe pse keni lejuar që disa institucione me tendera një burimor dhe shumë milionëshe, siç është rasti te Posta, KEK-u, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit. Në raportin tuaj, në tabelën 5.17, shohim se PTK e negociuar pas publikimit dhe njoftimi i kontratës është 27 milion, Ministria e Arsimit përsëritet prej një viti në vitin tjetër, çështja e blerjes së librave që është një tender shumë milionësh, te KEK-u është mbi 4 milion euro. Pyetja është si lejohen tenderët një burimor pa publikim, pa konkurrencë dhe të ipen milona, dhe për mua kjo është një keqpërdorim dhe keqmanxhim të institucioneve të republikës së Kosovës.

Safet Hoxha - sqarojë se përzgjedhja e procedurës është e drejtë ekskluzive e autoritetit kontraktues, nuk jemi ata që mundemi me e ndaluar. E dyta se ky lloj i procedurës përdoret ku ka arsye dhe detyrueshmëri teknike. Sa i përket rastit të PTK-së që ka të bëjë me projektin 3G, kemi kërkuar interpretim dhe na është thënë se nuk kanë mundur me zhvilluar sepse ka qenë në pronësi të Alkatelit me Siemensi dhe askush nuk mundet me konkure dhe ka qenë detyrim teknik. Te MASHT dhe blerja e librave me shumën prej 7 milionëve, na jemi duke folur për një ligj i cili bjen ndesh me drejtën autoriale, i kemi ngritur shqetësimet e njëjta.

Safete Hadergjona - ju si Komision Rregullativ i Prokurimit Publik, jeni edhe kompetent me dhënë edhe rekomandime për plotësim-ndryshimin e ligjit, a keni bërë ndonjë analizë të këtyre shkeljeve, he a janë këto shkelje, në përqindje, të aspektit procedural? Po ashtu e ceket edhe çështjen e procedurave burokratike të prokurimit, që janë pengesë edhe për bizneset në Kosovë, a keni bërë propozime për heqjen e këtyre procedurave dhe lehtësimin e punës në mënyrë që të dallohen shkeljet procedurale nga shkeljet tjera, që janë përgjegjës institucionet tjera.

Safet Hoxha - në bazë të analizës që kemi bërë që është edhe pjesë e raportit, kemi identifikuar secilin nen ku kemi gjetur shkelje. Në Kosovë janë 82 akte nënligjore të fushës së prokurimit publik dhe 8 udhëzime administrative, në aspektin voluminoz janë 1500 faqe. Jemi pjesë e grupit punës ku është duke u punuar në koncept dokumentin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të prokurimit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014.

9. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014

Hysni Hoxha – theksoi se në vitin që lamë pas, OSHP, ka pasur gjithsej në trajtim 530 ankesa në mënyrë takstative dhe prej këtyre ankesave, 181 janë vërtetuar vendimet e autoriteteve kontraktuese dhe janë refuzuar ankesat si të pa bazuara, 161 raste janë kthyer lëndët në rivlerësim, ndërsa në 104 raste OSHP ka anuluar aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese si të pabazuar. Në 13 raste kemi flakje të ankesave si jo të plota apo të cilat nuk kanë qenë në përputhje me dispozitat e ligjit e prokurimit publik, ndërsa 40 ankesa janë tërhequr para fazës së vendimmarrjes së panelit shqyrtues, 2 ankesa kanë qenë inkopetente, dhe 17 ankesa janë refuzuar si çështje të vendosura njëherë. Numrin me të madh të ankesave e kemi pas ndaj KEK-ut 34 ankesa, ndaj Policisë së Kosovës 32, ndaj PTK-së 27, Ministria e Infrastrukturës me 25 raste. Për lëndët që kemi kthyer në rivlerësim, buxheti i Kosovës ka fituar mbi 2,3 milion euro. Gjatë vitit të kaluar, OSHP, ka shqyrtuar edhe gjopa për organet kontraktuese, por edhe ndaj zyrtarëve të prokurimit, të cilët kanë hezitur të zbatojnë vendimet e OSHP-së. Sa i përket buxhetit, është shpenzuar 97%. Tejkalmi i shpenzimeve është për shpenzime për telefona dhe reprezentacion, por kemi edhe të hyra nga gjobat dhe sigurimi i ankesave të operatorëve ekonomik.

Kryetari – pyeti cila janë masat e juaja që keni ndërmarrë për shkeljet që janë bërë, cilat janë procedurat e mëtutjeshme? U theksua se Policia e Kosovës është e dyta sa i përket ankesave që janë bërë si autoritet. Unë kam një dokument që është adresuar në emrin tim dhe të komisionit dhe që ka të bëjë me një tender për furnizimin me uniformën policore, dhe sipas shkresës fitues i tenderit është shpallur kompania që ka ofertuar dyfish më shtrenjtë dhe sipas shkresës që na është drejtuar thuhet se diferenca në total është 7 milion euro. Kjo ka qenë edhe çështje mediave dhe e nevojshme të kemi një sqarim apo informatë. Megjithatë, kjo çështje nuk është objekt shqyrtimi në komisionin tonë, por është në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Hysen Hoxha - sa i përket numrit të madh të ankesave është e vërtetë se është në shpërputhje me buxhetin e Kosovës. OSHP nuk ka të drejtë të ndërhyjë nëse nuk ka ankesë. Sa i përket rastit të lëndës Policisë për furnizim me uniforma, vitin e kaluar OSHP, e ka shqyrtu një ankesë të operatorit ekonomik Unikat nga Peja dhe është vlerësuar i papërgjegjshëm, sepse nuk i ka plotësuar specifikat teknike dhe i cili ka kërkuar që të anulohet i tërë aktiviteti i prokurimit e jo të kthehet në rivlerësim. Pra ajo ankesë e këtij operatori ekonomik Unikat, ka qenë në kundërshtim me nenin 4, pika 1.26 të Ligjit të prokurimit publik, pasi që nuk ka mundur të dëshmojë interesin e tij material.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Kryetari – theksoi se në bazë të analizës dhe opinionit të ministrisë së financave, projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Edhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:44

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Naser Osmani